

AKTUALITET

Lihet në burg efektiv i FNSH-së që plagosi kushëririn në fytyrë: Më ofendoi



E HËNË 3 QERSHOR 2019, 14:17
TIRANAPOST



Lihet në burg efektiv i FNSH-së, Flamur Karaj, i cili plagosi dy ditë më parë me plumb në fytyrë kushëririn e tij, Enver Karaj, 48-vjeçari.

Gjykata e Tiranës la në masën e sigurisë ?Arrest në burg? punonjësin e FNSH, i cili u pezullua nga detyra. Sipas Prokurorisë, ngjarja ndodhi pas një sherri banal në Pezë.

Vetë Flamur Karaj pranoi ngjarjen, por tha se kushëririn e ofendoj dhe tentoi ta qëllonte dhe ai ka vepruar në kushtet e vetëmbrojtjes. Ndërkohë që avokati i tij mbrojtës kërkoi për të pandehurin ?arrest shtëpie?.

Kujtojmë se Enver Karaj, 48-vjeçari që u plagos me armë zjarri nga djali i xhaxhait ditën e shtunë. Mjekët thanë se ai ka një plagë në fytyrë, pasi plumbi i ka goditur nofullën dhe i ka dalë në faqe./ **Tiranapost.al**

<http://www.tiranapost.al/efektivi-i-fnsh-se-plagos-me-plumb-ne-koke-kusheririn/>

Ads by Revcontent

Worldwide Crypto Trading on Binance. Sign Up Now for Free!

The World's Leading Exchange

Buxheti 2021, buxheti i rindërtimit dhe rimëkëmbjes

5 arsye pse duhet të blesh një qiri (jo nga ato të zakonshmit)

Is Your PC Slow? Try this!

PC Cleaner - Download it now